

UDHËZIM
Nr. 6, datë 30.12.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ZBATIMIN E SISTEMEVE
INTELIGJENTE NË FUSHËN E TRANSPORTIT RRUGOR DHE LIDHJET ME
MËNYRAT E TJERA TË TRANSPORTIT RRUGOR¹**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 77/2 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e veprimit

Ky udhëzim:

1. Përcakton rregullat për të mbështetur zbatimin dhe përdorimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të sistemeve inteligjente të transportit, në vijim të referuara si SIT, në mënyrë koherente dhe të koordinuar me sisteme të ngjashme të zbatuara dhe të përdorura në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe parashikon kushtet e përgjithshme të nevojshme për këtë qëllim.

2. Rregullon disponueshmërinë e të dhënave dhe vënien në zbatim të shërbimeve të SIT-it brenda fushave prioritare të përcaktuara në nenin 2 të këtij udhëzimi, me mbulimin specifik gjeografik të përcaktuar në shtojcën III për të dhënat dhe me mbulimin specifik gjeografik të përcaktuar në shtojcën IV për shërbimet SIT.

3. Ky udhëzim zbatohet për aplikimet dhe shërbimet SIT në fushën e transportit rrugor dhe për ndërlidhjen e tyre me mënyrat e tjera të transportit, pa cenuar aspektet që lidhen me sigurinë kombëtare ose interesat e mbrojtjes kombëtare.

Neni 2
Fushat prioritare

1. Për qëllimet e këtij udhëzimi, fushat e mëposhtme konsiderohen prioritare për zhvillimin dhe përdorimin e specifikimeve dhe standardeve në përputhje me dispozitat e nenit 1:

- a) Fusha prioritare I: Shërbimet SIT për informacionin dhe lëvizshmërinë;
- b) Fusha prioritare II: Shërbimet SIT për udhëtimin, transportin dhe administrimin e trafikut;
- c) Fusha prioritare III: Shërbimet SIT për sigurinë dhe sigurinë rrugore;

¹ Ky udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë është plotësisht i përafshuar me direktivën 2010/40/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 7 korrik 2010, për kuadrin për vënien në zbatim të Sistemeve Inteligjente të Transportit në fushën e transportit rrugor dhe për ndërlidhjet me mënyrat e tjera të transportit, OJ L 207, 6.8.2010, f. 1–13, CELEX 32010L0040, ndryshuar me direktivën (EU) 2023/2661 (CELEX 32023L2661) dhe është plotësisht i përafshuar me vendimin zbatues të Komisionit (BE) 2025/264, të datës 11 nëntor 2024, që përcakton modelin që përfshin treguesit kryesorë të performancës për raportimin nga Shtetet Anëtare, sipas direktivës 2010/40/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (i njoftuar sipas dokumentit C(2024) 7744), OJ L 2025/264, 10.2.2025, f. 1–15, CELEX 32025D0264.

d) Fusha prioritare IV: Shërbimet SIT për lëvizshmërinë bashkëpunuese, të ndërlidhur dhe të automatizuar.

2. Zbatimi i fushave prioritare është përcaktuar në shtojcën I, pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

Neni 3 **Veprimet prioritare**

Brenda fushave prioritare, veprimet e mëposhtme konsiderohen si prioritare për zhvillimin dhe përdorimin e specifikimeve dhe standardeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në shtojcën I:

- a) ofrimi i shërbimeve të informacionit për udhëtimet multimodale;
- b) ofrimi i shërbimeve të informacionit në kohë reale për trafikun, siç përcaktohet në udhëzimin nr. 12, datë 30.12.2024, “Mbi ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale”.
- c) të dhënat dhe procedurat për ofrimin pa pagesë për përdoruesit, kur është e mundur, të informacionit minimal universal për sigurinë rrugore;
- ç) ofrimi i harmonizuar i një shërbimi telefonik elektronik (eCall) ndërveprues;
- d) ofrimi i shërbimeve të informacionit dhe të rezervimit për vende parkimi të sigurta për automjetet për përdorim tregtar.

Neni 4 **Përkufizime**

Për qëllimet e këtij udhëzimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Sistemet inteligjente të transportit” ose “SIT” janë sistemet që përdorin teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit në fushën e transportit rrugor, duke përfshirë infrastrukturën, automjetet dhe përdoruesit, si dhe në menaxhimin e trafikut dhe të lëvizshmërisë, si dhe për ndërlidhjet me mënyrat e tjera të transportit;
2. “Ndërveprueshmëri” është kapaciteti i sistemeve dhe proceseve kryesore të biznesit për shkëmbimin e të dhënave dhe ndarjen e informacioneve dhe njohurive, duke mundësuar vijimësinë e shërbimeve të SIT-it;
3. “Aplikim i SIT-it” është një instrument apo procedurë/kuadër operacional për aplikimin e SIT-it;
4. “Shërbim i SIT-it” është ofrimi i një aplikimi të SIT-it përmes një kuadri organizativ dhe operacional të mirëpërcaktuar, me synimin për të kontribuar në sigurinë e përdoruesit, efikasitetin, lëvizshmërinë e qëndrueshme ose komoditetin, lehtësimin dhe mbështetur operacionet e transportit dhe të udhëtimeve;
5. “Ofrues i shërbimit të SIT-it” është çdo ofrues i një shërbimi SIT, publik ose privat;
6. “Përdorues i SIT-it” është çdo përdorues i aplikimeve, ose i shërbimeve të SIT-it, duke përfshirë udhëtarët, përdoruesit e pambrojtur të rrugëve, përdoruesit dhe operatorët e infrastrukturës së transportit rrugor, administratorët e parqeve/stacioneve/terminaleve të automjeteve dhe operatorët e shërbimeve të emergjencës;
7. “Përdorues të pambrojtur të rrugëve” është çdo përdorues jomotorik i rrugës, siç janë këmbësorët dhe çiklistët, si dhe motoçiklistët dhe personat me aftësi të kufizuara ose me lëvizshmëri dhe orientim të reduktuar;
8. “Pajisje lëvizëse” është çdo pajisje elektronike portative komunikimi ose informacioni që mund të mbahet brenda automjetit për të ndihmuar në drejtimin e mjetit dhe/ose në operacionet e transportit;

9. “Platformë” është çdo njësi e vendosur brenda ose jashtë automjetit që mundëson vënien në zbatim, ofrimin, shfrytëzimin dhe integrimin e aplikimeve dhe shërbimeve SIT;
10. “Arkitekturë” është projekti konceptual që përcakton strukturën, sjelljen dhe integrimin e një sistemi të caktuar në kontekstin përreth tij;
11. “Ndërfaqja” është struktura lidhëse ndërmjet sistemeve, e cila siguron mjetet përmes të cilave sistemet mund të komunikojnë dhe të ndërveprojnë;
12. “Pajtueshmëri” është aftësia e përgjithshme e një pajisjeje ose sistemi për të punuar me një tjetër pajisje ose sistem pa modifikime;
13. “Vijimësia e shërbimeve” është aftësia për të siguruar shërbime të pandërprera në rrjetet e transportit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
14. “Të dhëna rrugore” janë të dhënat mbi karakteristikat e infrastrukturës rrugore, duke përfshirë sinjalet rrugore fikse dhe karakteristikat rregullatore të sigurisë së tyre, si dhe infrastrukturën për rikarikimin dhe furnizimin me lëndë djegëse alternative;
15. “Të dhëna mbi trafikun” janë të dhënat historike dhe në kohë reale për karakteristikat e trafikut rrugor;
16. “Të dhëna të udhëtimit” janë të dhënat kryesore, si oraret dhe tarifat e transportit publik, të nevojshme për të dhënë informacion për udhëtimet multimodale para dhe gjatë udhëtimit, për të lehtësuar planifikimin, prenotimin dhe përshtatjen e tij;
17. “Specifikim” është çdo masë detyruese që përcakton rregulla të cilat përmbajnë kërkesa, procedura ose rregulla të tjera relevante;
18. “Standard” është çdo standard ndërkombëtar, standard evropian (EN), standard i harmonizuar ose standard shqiptar, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 5, 6, 7, 9 dhe 10 të nenit 3 të ligjit nr. 8970, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar;
19. “Sisteme inteligjente bashkëpunuese të transportit”, ose “C-SIT”, janë sisteme inteligjente të transportit që u mundësojnë përdoruesve të SIT-it të ndërveprojnë dhe të bashkëpunojnë, duke shkëmbyer mesazhe të sigurt dhe të besuara, pa pasur njohuri paraprake për njëri-tjetrin dhe në mënyrë jodiskriminuese;
20. “Shërbim C-SIT” është çdo shërbim SIT i ofruar nëpërmjet C-SIT;
21. “Disponueshmëria e të dhënave” është ekzistenca e të dhënave në një format digjital të lexueshëm nga makina;
22. “Pikë kombëtare aksesit” ose “PKA” është Autoriteti Rrugor Shqiptar, që përbën pikën e vetme të aksesit për të dhënat, siç përcaktohet në udhëzimin nr. 12, datë 30.12.2024, “Mbi ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale”, dhe specifikimet e përmendura në nenin 7;
23. “Aksesueshmëria e të dhënave” është mundësia e kërkimit dhe e marrjes së të dhënave në një format digjital të lexueshëm nga makina;
24. “Shërbim i lëvizshmërisë digjitale multimodale” është shërbimi që ofron informacion mbi trafikun dhe të dhënat e udhëtimit, të tilla si vendndodhja e objekteve të transportit, oraret, disponueshmëria ose tarifat për më shumë se një mënyrë transporti, i cili mund të përfshijë module që mundësojnë kryerjen e rezervimeve, prenotimeve ose pagesave ose lëshimin e biletave;
25. “Informacion bazë” është informacioni brenda fushës së veprimt të këtij udhëzimi, që është përcaktuar si i rëndësishëm për informimin e përdoruesve të rrugës dhe të SIT-it, veçanërisht nga autoritetet rrugore, kur ato janë përgjegjëse për këtë informacion;
26. “Rrugë interurbane kryesore” është çdo rrugë e përcaktuar si e tillë nga ligji nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 5

Specifikimet për veprimet në fushat prioritare

1. Për veprimet brenda fushave prioritare të përcaktuara në nenin 2 të këtij udhëzimi, zhvillohen specifikime të veçanta dhe aty ku është e përshtatshme edhe standarde të nevojshme.

2. Specifikimet e veçanta do të miratohen veçanërisht në lidhje me shërbimet e:

- a) informacionit të trafikut në kohë reale;
- b) informacionit për vendet e sigurta dhe të mbrojtura të parkimit;
- c) informacionit minimal të trafikut të lidhura me sigurinë rrugore të ofruara pa pagesë;
- ç) informacionit të udhëtimit multimodal;
- d) thirrjes eCall;
- dh) sistemeve inteligjente bashkëpunuese të transportit.

Neni 6 **Vendosja e SIT-it**

1. Specifikimet miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin dhe zbatohen për të gjitha shërbimet dhe aplikimet e SIT-it të përcaktuara në këtë udhëzim, në momentin e zbatimit të tyre, në përputhje me shtojcën II, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Pika Kombëtare e Aksesit për çdo specifikim të veçantë të përmendur në nenin 5 të këtij udhëzimi vepron në përputhje me parimet e përcaktuara në shtojcën II.

3. Autoritetet përgjegjëse të listuara në nenin 15 bashkëpunojnë përmes Komitetit të Transportit për Planifikimin e SIT-it, të përcaktuar sipas nenit 14 të këtij udhëzimi, me autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe me grupet përkatëse të interesit kombëtare ose ndërkombëtare në funksion të fushave prioritare, për sa kohë që nuk ka specifikime të miratuara.

4. Autoritetet përgjegjëse të listuara në nenin 15 bashkëpunojnë përmes Komitetit të Transportit për Planifikimin e SIT-it me autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe, sipas rastit, me autoritetet përkatëse të vendeve të rajonit, në kuadër të bashkëpunimit ndërrajonal të Traktatit të Komunitetit të Transportit, për realizimin e projekteve të koordinimit të mbështetura nga Bashkimi Evropian, dhe ku është e përshtatshme me palët e interesuara relevante, për aspektet operacionale të zbatimit të specifikimeve të miratuara nga Komisioni Evropian, konkretisht:

- a) standardet dhe profilet e harmonizuara në nivelin e Bashkimit Evropian;
- b) përkufizimet, metadat, kërkesat e përbashkëta të cilësisë dhe aspektet në lidhje me ndërveprueshmërinë e arkitekturave të pikave kombëtare të aksesit;
- c) kushtet për shkëmbimin e të dhënave, aksesin e sigurt, si dhe aktivitetet e përbashkëta të trajnimit dhe informimit.

5. Për sa u përket kërkesave për ofruesit e të dhënave, përdoruesit e të dhënave dhe ofruesit e shërbimeve të SIT-it, të përcaktuara në specifikimet e miratuara, autoritetet përgjegjëse të listuara në nenin 15 bashkëpunojnë përmes Komitetit të Transportit për Planifikimin e SIT-it me autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, në lidhje me praktikën për vlerësimin e pajtueshmërisë me këto kërkesa, zhvillimin e mekanizmave për zbatimin e pajtueshmërisë dhe çështje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkufitar.

Neni 7 **Specifikimet**

1. Ministri përgjegjës për transportin miraton specifikimet e nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë, ndërveprimin dhe vazhdimësinë e vendosjes dhe përdorimit operativ të SIT-it për veprimet prioritare.

2. Ministri përgjegjës për transportin, pas miratimit të specifikimeve të nevojshme për veprimet prioritare, miraton specifikimet që sigurojnë pajtueshmërinë, ndërveprimin dhe vazhdimësinë e vendosjes dhe përdorimit operativ të SIT-it për veprimet e tjera në fushat prioritare.

3. Kur është e përshtatshme dhe në varësi të fushës së mbuluar nga specifikimi, ky përfshin një ose më shumë nga llojet e dispozitave të mëposhtme:

a) dispozita funksionale, që përshkruajnë rolet e palëve të ndryshme të interesit dhe qarkullimin e informacionit ndërmjet tyre;

b) dispozita teknike, që parashikojnë mjetet teknike për përmbushjen e dispozitave funksionale;

c) dispozita organizative, që përshkruajnë detyrimet procedurale të grupeve të ndryshme të interesit;

d) dispozita lidhur me shërbimet, që përshkruajnë nivele të ndryshme të shërbimeve dhe përmbajtjen e tyre për aplikacionet dhe shërbimet SIT.

4. Specifikimet, kur është e përshtatshme, duhet të bazohen në standardet të referuara në pikën 18, të nenit 4 dhe në përputhje me shtojcën II, të këtij udhëzimi.

5. Specifikimet përcaktojnë që ministri përgjegjës pas konsultimit me Komitetin të Transportit për Planifikimin e SIT-it, të miratojë rregulla shtesë për ofrimin e shërbimeve të SIT-it, përveç atyre të zbatuara në Bashkimin Evropian, për të gjithë territorin ose për një pjesë të territorit të Republikës së Shqipërisë. Këto rregulla shtesë nuk pengojnë ndërveprueshmërinë me aplikacionet dhe shërbimet e SIT të përdorura në Bashkimin Evropian.

6. Këto specifikime bazohen sipas rastit në standardet e referuara në pikën 18, të nenit 4, dhe janë në përputhje me shtojcën II, pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

7. Këto specifikime përfshijnë rregulla për vendosjen e parametrave që lidhen me cilësinë dhe përshtatshmërinë për përdorim. Sipas rastit, dhe veçanërisht për arsye sigurie dhe ndërveprueshmërie, specifikimet përfshijnë rregulla për vlerësimin e konformitetit dhe mbikëqyrjen e tregut, duke përfshirë një dispozitë mbrojtëse në përputhje me ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

8. Ministri përgjegjës për transportin mund të caktojë një ose më shumë organe kompetente për vlerësimin e pajtueshmërisë me kërkesat e miratuara në specifikime, në varësi të rregullave të veçanta të vlerësimit të përcaktuara në to.

9. Çdo specifikim mbulon jo më shumë se një fushë prioritare dhe miratohet për çdo veprim prioritar.

Neni 8

Disponueshmëria e të dhënave dhe vënia në zbatim e shërbimeve SIT

1. Informacioni bazë, me të dhënat për çdo zonë gjeografike publikohet dhe bëhet i disponueshëm në faqen e *web*-it të Pikës Kombëtare të Aksesit nga ofruesit e të dhënave, në përputhje me llojin e të dhënave dhe afatet e përcaktuara në shtojcën III.

2. Ofruesit e të dhënave përditësojnë dhe bëjnë të disponueshme pa vonesë në faqen e *web* të Pikës Kombëtare të Aksesit, të dhënat që i korrespondojnë informacionit bazë, të cilat janë krijuar ose përditësuar në ose pas datës së përcaktuar në kolonën e tretë të shtojcës III.

3. Ofruesit e të dhënave që publikojnë dhe bëjnë të disponueshëm në faqen e *web* të Pikës Kombëtare të Aksesit, lloje të tjera të dhënash, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, respektojnë afatet e përcaktuara në shtojcën III dhe i përditësojnë këto të dhëna kurdo që është e nevojshme.

4. Afatet për publikimin dhe bërjen të disponueshme të të dhënave për të cilat nuk është përcaktuar një afat në kolonën e katërt të shtojcës III, përcaktohen nga ministri përgjegjës për transportin.

5. Afatet e përcaktuara në shtojcën III, zbatohen vetëm për infrastrukturën ekzistuese. Për infrastrukturën e re, të dhënat e përcaktuara në shtojcën III publikohen dhe bëhen të disponueshme në faqen e *web* të Pikës Kombëtare të Aksesit, në datën e hapjes së kësaj infrastrukture për trafikun rrugor.

6. Ofruesit e shërbimeve të SIT-it janë përgjegjës që shërbimet e SIT-it të përcaktuara në shtojcën IV të zbatohen për zonën gjeografike të mbuluar sa më shpejtë që është mundur dhe në asnjë rast, jo më vonë se datat korresponduese të përcaktuara në këtë Shtojcë.

Neni 9 **Standardet**

1. Në fushat prioritare dhe për veprimet prioritare zhvillohen standardet e nevojshme për të siguruar ndërveprueshmërinë, përputhshmërinë dhe vijimësinë për vënien në zbatim dhe përdorimin operacional të SIT-it. Për këtë qëllim, ministria përgjegjëse për transportin, pas konsultimeve me Komitetin e Transportit për Planifikimin e SIT-it, i propozon Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 15 të ligjit nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, adoptimin e standardeve evropiane përkatëse, si standarde shqiptare.

2. Ministria përgjegjëse për transportin paraqet propozimin për institucionin përgjegjës për standardizimit, në përputhje me shtojcën II, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, si dhe çdo dispozitë funksionale të përfshirë në një specifikim të miratuar në përputhje me nenin 7.

Neni 10 **Sistemi për administrimin e kredencialeve të sigurisë të C-SIT**

1. Specifikimet për fushën prioritare të përmendur në nenin 2, pika 1, shkronja “d”, të miratuara nga ministri përgjegjës për transportin, mbulojnë sistemin për administrimin e kredencialeve të sigurisë të C-SIT të përmendur në pikën 4.3 të shtojcës I. Specifikimet për këtë sistem përcaktojnë detyrat e autoriteteve të mëposhtme:

- a) autoritetit përgjegjës për politikat e certifikatave të C-SIT;
- b) administratorit të listës së besueshme të C-SIT;
- c) pikës së kontaktit të C-SIT.

2. Ministri përgjegjës për transportin është përgjegjës për të garantuar kryerjen e detyrave nga këto autoritete.

Neni 11 **Mbrojtja e të dhënave personale**

1. Përpunimi i të dhënave personale në kuadër të zbatimit të aplikacioneve dhe shërbimeve SIT që janë objekt i këtij udhëzimi, bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe me dispozitat e ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, vetëm në masën që ky përpunim është i nevojshëm për funksionimin e duhur të aplikacioneve, shërbimeve dhe veprimeve të SIT-it të parashikuara në shtojcën I, me qëllim garantimin e sigurisë rrugore dhe përmirësimin e menaxhimit të trafikut.

2. Ofruesit e të dhënave, përdoruesit e të dhënave dhe ofruesit e aplikacioneve dhe shërbimeve SIT:

a) përcaktojnë kategoritë e të dhënave që i nënshtrohen përpunimit të të dhënave personale, sikurse përcaktuar në ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

b) përpara përdorimit të të dhënave bëjnë vlerësimin e ndikimit të përpunimit të të dhënave mbi mbrojtjen e të dhënave personale, sikurse përcaktuar në ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

c) kanë detyrimin të mbrojnë të dhënat personale nga keqpërdorimi, duke përfshirë edhe aksesin, modifikimin ose humbjen e paautorizuar të tyre.

3. Subjektet që zbatojnë aplikacionet dhe shërbimet e SIT-it përdorin të dhëna anonime kur anonimizimi është i mundur dhe qëllimet e përpunimit të të dhënave mund të arrihen me të dhëna të anonimizuara për funksionimin e duhur të aplikacioneve dhe shërbimeve të SIT-it, duke pasur parasysh kërkesat e pikës 1 të këtij neni.

4. Kur anonimizimi nuk është teknikisht i realizueshëm, ose qëllimet e përpunimit të të dhënave nuk mund të arrihen me të dhëna të anonimizuara, të dhënat të jepen me pseudonim, me kusht që pseudonimi të jetë teknikisht i realizueshëm dhe qëllimet e përpunimit të të dhënave të mund të arrihen me përdorimin e të dhënave me pseudonim.

5. Të dhënat personale përpunohen vetëm në masën e nevojshme për funksionimin e duhur të aplikacioneve dhe të shërbimeve SIT dhe duke pasur parasysh kërkesat e pikës 1 të këtij neni.

Neni 12

Të dhënat e hapura dhe ripërdorimi i informacionit të sektorit publik

Në kuadër të zbatimit të aplikacioneve dhe shërbimeve SIT që janë brenda fushës së veprimit të këtij udhëzimi, përdorimi i të dhënave të hapura dhe ripërdorimi i informacionit të institucionet publike kombëtare apo vendore, kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 13

Përgjegjësia e ofruesit të aplikacioneve dhe shërbimeve SIT

Ofruesi i aplikacioneve dhe i shërbimeve SIT brenda fushës së veprimit të këtij udhëzimi, në përputhje me shtojcat III dhe IV, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, mbajnë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara nga produktet me defekt në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 14

Rregullat mbi përgjegjësinë

1. Autoritetet përgjegjëse të sigurojnë që çështjet që lidhen me përgjegjësinë, për sa i përket vendosjes dhe përdorimit të aplikacioneve dhe shërbimeve të SIT-it të përcaktuara në specifikimet e miratuara sipas nenit 6, janë trajtuar në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar.

2. Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) administron:

a) Sistemin e menaxhimit të trafikut, që nënkupton një sistem, i cili konsiston në instalimin e pajisjeve stacionare trafikmatëse në akset kryesore të rrjetit rrugor kombëtar. Ky sistem i ofron ARRSH-së të dhëna trafiku në kohë reale dhe është në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi monitorimin

e trafikut në rrjetin rrugor kombëtar dhe udhëzimit nr. 12, datë 30.12.2024, “Mbi ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale”.

b) Qendrën e Monitorimit dhe Kontrollit të Trafikut Rrugor, që ka për qëllim përfshirjen e shërbimeve SIT dhe për realizimin e këtij qëllimi, bashkëpunon me Institutin e Transportit dhe Policinë Rrugore.

c) Sistemin “WEB-GIS”, që është një sistem i cili shërben si një inventar i hollësishëm i rrjetit rrugor kombëtar, duke ndihmuar në miradministrimin e të dhënave përkatëse. Ky sistem është ndërtuar në përputhje me standardet evropiane INSPIRE dhe ligjin nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor”, të ndryshuar.

Neni 15

Planifikimi i aplikacioneve dhe i shërbimeve SIT

1. Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it harton planin për aplikimin e sistemeve inteligjente në transportin rrugor dhe monitoron zbatimin e tij.

2. Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it harton raportin vjetor për zbatimin e këtij plani.

3. Plani për aplikimin e sistemeve inteligjente në transportin rrugor miratohet nga ministri përgjegjës për transportin.

Neni 16

Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it

1. Në zbatim të këtij udhëzimi, krijohet Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it, për planifikimin e veprimeve prioritare, si dhe koordinimin e iniciativave në zbatim të teknologjive të informacionit të transportit rrugor dhe multimodal, në ndërveprim me llojet e tjera të transportit, siç janë ai hekurudhor dhe i kombinuar, detar dhe ajror, dhe sektorëve të infrastrukturës.

2. Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it kryesohet nga zëvendësministri përgjegjës për transportin rrugor dhe përbëhet nga përfaqësues të:

- a) Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- b) Autoritetit Rrugor Shqiptar;
- c) Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- ç) Institutit të Transportit;
- d) Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

3. Në mbledhjet e Komitetit të Transportit për Planifikimin e SIT-it ftohen të marrin pjesë përfaqësues të këtyre institucioneve:

- a) Ministrisë së Punëve të Brendshme/Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- b) Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit/Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimi;
- c) Ministrisë së Financave;
- ç) Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor;
- d) INSTAT-it;
- dh) Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- e) Autoritetit të Konkurrencës.

Neni 17

Grupi këshillues për zbatimin e SIT-it

1. Për të përdorur në mënyrë efikase rrjetet e transportit rrugor dhe multimodal, formohet grupi këshillues për zbatimin e SIT-it, për të dhënë sugjerime për Komitetin e Transportit për Planifikimin e SIT, në aspektin tregtar dhe teknik të vendosjes dhe përdorimit të SIT-it, në të gjithë territorin shqiptar. Ky grup përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë, nga ofruesit e shërbimeve përkatëse SIT, shoqatat e përdoruesve të aplikacioneve SIT në sektorin e transportit dhe infrastrukturës, operatorët e transportit rrugor dhe multimodal në ndërveprim me llojet e tjera, shoqatat e bashkive etj.

2. Operatorët e tjerë përfshijnë, për sa është e mundur, transportuesit hekurudhorë dhe intermodal e të kombinuar, detar dhe ajror, si dhe operatorët e impianteve të shërbimit apo objekteve, industrinë e krijimit të këtyre aplikacioneve SIT, partnerët socialë, shoqatat profesionale, autoritetet lokale dhe forume të tjera përkatëse në platformat e konsultimit të autoriteteve përgjegjëse me palët e interesit.

3. Grupi këshillues dhe operatorët e tjerë, të cituar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, udhëzohen për të kontribuar, ku është e nevojshme, për zbatimin aktual dhe të mëtejshëm të dokumenteve strategjike në sektorin e transportit dhe veçanërisht në zbatimin dhe ofrimin e aplikacioneve dhe shërbimeve të SIT, në koordinimin e praktikave të tyre më të mira me veprimet prioritare të sektorit të transportit dhe infrastrukturës.

Neni 18 **Raportimi**

1. Brenda datës 21 mars 2026, Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it i paraqet ministrit përgjegjës për transportin, raportin fillestar mbi zbatimin e këtij udhëzimi dhe të urdhrave të miratuar mbi zbatimin e sistemeve inteligjente të transportit, si dhe mbi aktivitetet dhe projektet kryesore kombëtare, në lidhje me fushat prioritare dhe me disponueshmërinë e të dhënave dhe shërbimeve të renditura në shtojcat III dhe IV, pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

2. Modeli i raportit fillestar dhe i atyre të përparimit, duke përfshirë listën e treguesve kryesorë të performancës për vlerësimin e zbatimit të këtij udhëzimi dhe urdhrave për zbatimin e sistemeve inteligjente në transport është bashkëlidhur si shtojca V dhe shtojca VI pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

3. Raporti i parë i përparimit do të plotësohet brenda datës 21 mars 2028 dhe më pas çdo tre vjet mbi përparimin e bërë lidhur me zbatimin e këtij udhëzimi dhe të urdhrave të miratuar për zbatimin e sistemeve inteligjente në transport.

Neni 19 **Dispozita të fundit**

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen, të gjitha institucionet dhe subjektet e përmendura në këtë udhëzim.

2. Udhëzimi i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 3616/3, datë 21.7.2017, “Për rregullat për zbatimin e sistemeve inteligjente në fushën e transportit rrugor dhe lidhjet me mënyrat e tjera të transportit”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

SHTOJCA I FUSHAT PRIORITARE

1. Fusha prioritare I: Shërbimet SIT për informacionin dhe lëvizshmërinë

Specifikimet dhe standardet për shërbimet e SIT-it për informacionin dhe lëvizshmërinë për udhëtarët përfshijnë sa më poshtë:

1.1. Specifikimet për shërbimet e lëvizshmërisë digjitale multimodale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (përfshirë shërbimet e informacionit mbi udhëtimet multimodale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë).

Përcaktimi i kërkesave të nevojshme në mënyrë që shërbimet e lëvizshmërisë digjitale multimodale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe shërbime të ngjashme që ofrojnë informacion ose veçori prenotimi ose blerjeje për më shumë se një operator transporti brenda së njëjtës mënyrë transporti të jenë të sakta dhe të disponueshme përtej kufijve për përdoruesit e SIT, bazuar në:

1.1.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë për ofruesit e shërbimeve të SIT të të dhënave ekzistuese dhe të sakta mbi trafikun dhe udhëtimet multimodale që përdoren për shërbimet e lëvizshmërisë digjitale multimodale, pa cenuar kufizimet e sigurisë dhe të menaxhimit të transportit;

1.1.2. lehtësimin e shkëmbimit ndërkufitar të të dhënave elektronike ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit përkatëse dhe ofruesve përkatës të shërbimeve të SIT-it, veçanërisht përmes ndërfaqeve të standardizuara;

1.1.3. përditësimin në kohë nga autoritetet publike dhe grupet e interesit përkatëse të të dhënave të disponueshme mbi trafikun dhe udhëtimet multimodale që përdoren për shërbimet e lëvizshmërisë digjitale multimodale;

1.1.4. përditësimin në kohë të informacionit mbi udhëtimet multimodale, duke përfshirë informacionin, në lidhje me prenotimet dhe blerjet, sipas rastit, të shërbimeve të transportit nga ofruesit e shërbimeve të SIT-it.

1.2. Specifikimet për shërbimet e informacionit mbi trafikun rrugor dhe navigimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (duke përfshirë shërbimet e informacionit mbi trafikun në kohë reale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë).

Përcaktimi i kërkesave të nevojshme në mënyrë që shërbimet e informacionit mbi trafikun rrugor dhe të navigimit në mbarë BE-në të jenë të sakta dhe të disponueshme për përdoruesit ndërkufitarë të SIT, bazuar në:

1.2.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë për ofruesit e shërbimeve të SIT-it dhe grupet e tjera përkatëse të interesit, si dhe për përdorim në hartat digjitale, të të dhënave ekzistuese dhe të sakta mbi rrugët dhe trafikun, duke përfshirë të dhënat në kohë reale, që përdoren për informacionin mbi trafikun në kohë reale, pa cenuar kufizimet e sigurisë dhe të menaxhimit të transportit;

1.2.2. lehtësimin e shkëmbimit ndërkufitar të të dhënave elektronike ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit përkatëse dhe ofruesve përkatës të shërbimeve të SIT-it, duke përfshirë komentet mbi cilësinë e të dhënave;

1.2.3. përditësimin në kohë të të dhënave të disponueshme mbi rrugët dhe trafikun që përdoren për informacionin mbi trafikun në kohë reale nga autoritetet publike dhe grupet e interesit përkatëse;

1.2.4. përditësimin në kohë të informacionit mbi trafikun në kohë reale për përdoruesit e rrugëve dhe grupet e tjera përkatëse të interesit nga ofruesit e shërbimeve të SIT-it;

1.3. Specifikimet për shërbimet e lëvizshmërisë digjitale multimodale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe shërbimet e informacionit mbi trafikun rrugor dhe të navigimit;

1.3.1. Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për mbledhjen nga autoritetet publike përkatëse dhe/ose, sipas rastit, nga sektori privat, të të dhënave mbi rrugët dhe trafikun (pra planet e qarkullimit rrugor, rregullat e trafikut dhe rrugët e rekomanduara, veçanërisht për automjetet e rënda) dhe për ofrimin e tyre për ofruesit e shërbimeve të SIT, bazuar në:

1.3.1.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë, për ofruesit e shërbimeve të SIT-it, të të dhënave ekzistuese mbi rrugët dhe trafikun (pra planet e qarkullimit rrugor, rregullat mbi trafikun dhe rrugët e rekomanduara) të mbledhura nga autoritetet publike përkatëse dhe/ose sektori privat;

1.3.1.2. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave elektronike ndërmjet autoriteteve publike dhe ofruesve të shërbimeve të SIT-it dhe grupeve të tjera përkatëse të interesit;

1.3.1.3. përditësimin në kohë, nga autoritetet publike përkatëse dhe/ose, sipas rastit, nga sektori privat, të të dhënave mbi rrugët dhe trafikun (pra planet e qarkullimit rrugor, rregullat e trafikut dhe rrugët e rekomanduara);

1.3.1.4. përditësimin në kohë, nga ofruesit e shërbimeve të SIT-it, të shërbimeve dhe aplikimeve të SIT që përdorin këto të dhëna mbi rrugët dhe trafikun.

1.3.2. Përcaktimi i kërkesave të nevojshme në mënyrë që të dhënat mbi rrugët, trafikun dhe udhëtimet përkatëse dhe infrastrukturën multimodale që përdoren për hartat digjitale të jenë të sakta dhe të disponueshme, kur është e mundur, për krijuesit e hartave digjitale dhe ofruesit e shërbimeve, bazuar në:

1.3.2.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë për krijuesit e hartave digjitale dhe ofruesit e shërbimeve të të dhënave ekzistuese mbi rrugët, trafikun dhe udhëtimet përkatëse dhe infrastrukturën multimodale, duke përfshirë nyjat e identifikuara të aksesit, që përdoren për hartat digjitale;

1.3.2.2. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave elektronike ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit përkatëse dhe krijuesve privatë të hartave digjitale dhe ofruesve të shërbimeve;

1.3.2.3. përditësimin në kohë të të dhënave mbi rrugët dhe trafikun për hartat digjitale nga autoritetet publike dhe grupet e interesit përkatëse;

1.3.2.4. përditësimin në kohë të hartave digjitale nga krijuesit e hartave digjitale dhe ofruesit e shërbimeve.

2. Fusha prioritare II: Shërbimet e SIT-it për udhëtimin, transportin dhe administrimin e trafikut

Specifikimet dhe standardet për shërbimet e SIT-it për udhëtimin, transportin dhe administrimin e trafikut përfshijnë sa më poshtë:

2.1. Specifikimet për shërbimet e përmirësuara të menaxhimit të trafikut dhe incidenteve

Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për të mbështetur dhe harmonizuar shërbimet e përmirësuara të menaxhimit të trafikut dhe incidenteve, bazuar në:

2.1.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e të dhënave ekzistuese dhe të sakta mbi rrugët dhe trafikun dhe të dhënave mbi aksidentet dhe incidentet që nevojiten për shërbimet e menaxhimit të trafikut dhe incidenteve;

2.1.2. lehtësimin e shkëmbimit ndërkufitar të të dhënave elektronike, duke përfshirë të dhënat mbi transportin e mallrave, që janë të rëndësishme për administrimin e trafikut dhe të incidenteve (p.sh. transporti i mallrave të rrezikshme, kufizimet e aksesit të lidhura me mallrat, ngarkesat që tejkalojnë përmasat e lejuara), ndërmjet qendrave të menaxhimit të trafikut, qendrave të informacionit mbi trafikun, grupeve të interesit dhe ofruesve të shërbimeve të SIT-it, veçanërisht përmes ndërfaqeve të standardizuara;

2.1.3. përditësimin në kohë të të dhënave të disponueshme mbi rrugët dhe trafikun dhe të dhënave mbi aksidentet dhe incidentet që nevojiten për shërbimet e përmirësuara të menaxhimit të trafikut dhe incidenteve nga grupet të interesit përkatëse;

2.1.4. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e të dhënave dhe sinergjitë me nisma të tjera që synojnë mbështetjen e multimodalitetit, integrimin e mënyrave të transportit dhe lehtësimin e kalimit modal në rrjetin evropian të transportit drejt mënyrave më të qëndrueshme të transportit, nëpërmjet harmonizimit dhe lehtësimit të shkëmbimit të të dhënave.

2.2. Specifikimet për shërbimet e menaxhimit të lëvizshmërisë

Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për të mbështetur zhvillimin e shërbimeve të sakta të menaxhimit të lëvizshmërisë nga autoritetet e transportit publik, bazuar në:

2.2.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë për autoritetet publike përkatëse, në një format të standardizuar, të të dhënave ekzistuese e të sakta mbi udhëtimet dhe trafikun rrugor dhe multimodal, që nevojiten për administrimin e lëvizshmërisë, pa cenuar kërkesat për mbrojtjen e të dhënave;

2.2.2. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave elektronike përtej kufijve ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit përkatëse dhe ofruesve përkatës të shërbimeve të SIT-it;

2.2.3. përditësimin në kohë të të dhënave të disponueshme mbi udhëtimet dhe trafikun rrugor dhe multimodal që nevojiten për administrimin e lëvizshmërisë nga autoritetet publike dhe grupet e interesit përkatëse.

2.3. Kuadri i BE-së për arkitekturën e SIT-it

Përcaktimi i masave të nevojshme për të zhvilluar një kuadër kombëtar për arkitekturën e SIT-it, që adreson në mënyrë specifike ndërveprueshmërinë e lidhur me SIT-et, vijimësinë e shërbimeve dhe aspektet e multimodalitetit, mbi bazën e të cilit autoritetet kompetente, në bashkëpunim me sektorin privat, mund të zhvillojnë arkitekturën e tyre të SIT-it për lëvizshmërinë në nivel kombëtar, rajonal ose lokal.

2.4. Aplikimet SIT dhe logjistika e transportit të mallrave

Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për të mbështetur realizimin e aplikimeve të SIT-it për logjistikën e transportit të mallrave, veçanërisht për gjurmimin dhe ndjekjen e mallrave dhe shërbimet e tjera të vizibilitetit përgjatë transportit të tyre multimodal, bazuar në:

2.4.1. disponueshmërinë e teknologjive përkatëse të SIT-it dhe përdorimin e tyre nga zhvilluesit e aplikimeve të SIT-it;

2.4.2. disponueshmërinë e të dhënave të lidhura me ngarkesën, të aksesueshme përmes kuadrove të tjera specifike të shkëmbimit të të dhënave

2.4.3. integrimin e rezultateve të pozicionimit në mjetet dhe qendrat e menaxhimit të trafikut.

3. Fusha prioritare III: Shërbimet SIT për sigurinë rrugore dhe mbrojtjen

Specifikimet dhe standardet për shërbimet e SIT-it për sigurinë rrugore dhe mbrojtjen përfshijnë sa më poshtë:

3.1. Specifikimet për shërbimin telefonik elektronik (eCall) ndërveprues në mbarë territorin e Republikës së Shqipërisë

Përcaktimi i masave të nevojshme për ofrimin e harmonizuar të një shërbimi telefonik elektronik (eCall) ndërveprues në mbarë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë:

3.1.1. disponueshmërinë e të dhënave të SIT-it brenda automjetit që janë të nevojshme për t'u shkëmbyer;

3.1.2. disponueshmërinë e pajisjeve të nevojshme në qendrat e përgjigjes ndaj thirrjeve emergjente që marrin të dhënat e dërguara nga automjetet;

3.1.3. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave elektronike ndërmjet automjeteve dhe qendrave të përgjigjes ndaj thirrjeve emergjente, duke përfshirë ndërveprimin e mundshëm me të dhënat e përfshira në aktin ligjor që rregullon komunikimin elektronik të informacionit rregullator dhe me

Protokollin Shtesë të Konventës për Kontratën për Transportin Ndërkombëtar të Mallrave Rrugore (eCMR), në lidhje me elektronike të ngarkesës, sikurse aderuar me ligjin nr. 59/2025, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shtesë të Konventës për Kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (CMR), në lidhje me faturën elektronike të ngarkesës, bërë në Gjenevë në datën 20.2.2008”, si për shembull në rastin e mallrave të rrezikshme.

3.2. Specifikimet për shërbimet e informacionit dhe të rezervimit për vende parkimi të sigurta për kamionët dhe mjetet për përdorim tregtar

Përcaktimi i masave të nevojshme për të siguruar informacion të bazuar te SIT-it dhe, kur është e mundur, shërbimet e rezervimit për vende parkimi të sigurta për kamionët dhe mjetet për përdorim tregtar, veçanërisht në zonat e shërbimit dhe të pushimit në rrugë, bazuar në:

3.2.1. disponueshmërinë e informacionit mbi parkimin për përdoruesit;

3.2.2. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave elektronike ndërmjet vendeve dhe hapësirave të parkimit, qendrave dhe automjeteve;

3.2.3. integrimin e teknologjive përkatëse të SIT-it si në automjete, ashtu edhe në mjediset e parkimit, për të përditësuar informacionin mbi hapësirat e disponueshme të parkimit për qëllime rezervimi.

3.3. Specifikimet për informacionin universal minimal mbi trafikun në lidhje me sigurinë rrugore

Përcaktimi i kërkesave minimale për dhënien pa pagesë për përdoruesit, kur është e mundur, të “informacionit universal mbi trafikun”, në lidhje me sigurinë rrugore, si dhe përcaktimi i përmbajtjes së tyre minimale, bazuar në:

3.3.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e të dhënave të sakta mbi ngjarjet dhe kushtet e lidhura me sigurinë (rrugore) që nevojiten për informacionin mbi trafikun që lidhet me sigurinë dhe shërbimet e menaxhimit të incidenteve/aksidenteve;

3.3.2. vënien në zbatim ose përdorimin e mjeteve për zbulimin ose identifikimin e ngjarjeve dhe kushteve të lidhura me sigurinë rrugore;

3.3.3. identifikimin dhe përdorimin e një liste të standardizuar të ngjarjeve të trafikut që lidhen me sigurinë rrugore (“mesazhet universale të trafikut”), e cila duhet t’u komunikohet përdoruesve të SIT-it pa pagesë;

3.3.4. pajtueshmërinë dhe integrimin e “mesazheve universale të trafikut” në shërbimet e SIT-it për informacionin mbi trafikun dhe udhëtimet multimodale.

3.4. Specifikimet për veprime të tjera

3.4.1. Përcaktimi i masave të nevojshme për të mbështetur sigurinë e përdoruesve të rrugës, në lidhje me ndërfaqen/ndërveprimin e tyre “njeri-makineri” (*Human-Machine Interface*) brenda mjetit dhe përdorimin e pajisjeve nomade, duke përfshirë telefonat celularë, për të ndihmuar në drejtimin e mjetit dhe/ose funksionimin e transportit, si dhe sigurinë e komunikimeve brenda mjetit, të cilat nuk klasifikohen si automjete bujqësore dhe pyjore, mjete motorike me 2 ose 3 rrota ose kuadricikla, ose si automjete të kategorive M dhe N dhe rimorkio të kategorisë O.

3.4.2. Përcaktimi i masave të nevojshme për të përmirësuar sigurinë dhe komoditetin e përdoruesve të cënueshëm të rrugëve për të gjitha aplikimet përkatëse të SIT-it për mjetet të cilat nuk klasifikohen si automjete bujqësore dhe pyjore, mjete motorike me 2, 3 ose 4 rrota, ose si automjete të kategorive M dhe N dhe rimorkio të kategorisë O.

3.4.3. Përcaktimi i masave të nevojshme për integrimin e sistemeve të avancuara të informacionit për mbështetjen e drejtuesve në automjete dhe në infrastrukturën rrugore, të cilat nuk klasifikohen si automjete bujqësore dhe pyjore, mjete motorike me 2, 3 ose 4 rrota, ose si automjete të kategorive M dhe N dhe rimorkio të kategorisë O.

3.4.4. Përcaktimi i masave të nevojshme për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit ndërmjet ofruesve të shërbimeve për aplikimet e SIT-it për sigurinë, siç është mbështetja për rikuperimin e

mjeteve ose mallrave të vjedhura, dhe autoriteteve publike përkatëse, duke marrë parasysh siç duhet kuadrot e tjera ekzistuese dhe ato në zhvillim e sipër që synojnë lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave mbi lëvizshmërinë dhe transportin që nuk klasifikohen si automjete bujqësore dhe pyjore, mjete motorike me 2, 3 ose 4 rrota, ose si automjete të kategorive M dhe N dhe rimorkio të kategorisë O.

4. Fusha prioritare IV: Shërbimet e SIT-it për lëvizshmërinë bashkëpunuese, të lidhur dhe të automatizuar

Specifikimet dhe standardet për lidhjen e automjeteve me infrastrukturën e transportit, rritjen e ndërgjegjësimit dhe mundësimin e shërbimeve të lëvizshmërisë me shkallë të lartë automatizimi përfshijnë sa më poshtë vijon, pa cenuar specifikimet dhe standardet që kanë të bëjnë me automjetet bujqësore dhe pyjore, mjetet motorike me 2, 3 ose 4 rrota, ose automjetet e kategorive M dhe N dhe rimorkiot e kategorisë O:

4.1. Përcaktimi i masave të nevojshme për të avancuar më tej zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve bashkëpunuese inteligjente të transportit (automjet-automjet, automjet-infrastrukturë, infrastrukturë-infrastrukturë), veçanërisht për të mbështetur mobilitetin bashkëpunues, të lidhur dhe të automatizuar (CCAM), bazuar në:

4.1.1. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave ose informacionit midis automjeteve, midis infrastrukturave dhe midis automjeteve dhe infrastrukturave, si dhe midis përdoruesve të tjerë të rrugës dhe automjeteve dhe infrastrukturave;

4.1.2. disponueshmërinë e të dhënave ose informacioneve përkatëse që duhet të shkëmbehen për palët përkatëse, qoftë automjet apo infrastrukturë rrugore;

4.1.3. përdorimin e një formati të standardizuar të mesazheve për shkëmbimin e të dhënave ose informacionit midis automjetit dhe infrastrukturës;

4.1.4. përcaktimin e një infrastrukture të saktë dhe të besueshme të komunikimit për shkëmbimin e të dhënave ose informacionit midis automjeteve, midis infrastrukturave dhe midis automjeteve dhe infrastrukturave;

4.1.5. përdorimin e proceseve të standardizimit për të miratuar arkitekturat përkatëse.

4.2. Specifikimet për shërbimet

4.2.1. Shërbimet e C-SIT për informacionin dhe për paralajmërimin bazuar në të dhënat mbi statusin, që rrisin ndërgjegjësimin e përdoruesve të transportit për situatat e ardhshme të trafikut;

4.2.2. Shërbimet e C-SIT për informacionin dhe për paralajmërimin bazuar në vrojtime, që rrisin më tej ndërgjegjësimin e përdoruesve të transportit për situatat e ardhshme të trafikut, duke përfshirë përdoruesit jo të lidhur të transportit;

4.2.3. Shërbimet e C-SIT bazuar në synime që u lejojnë automjeteve të trajtojnë skenarë kompleksë të trafikut dhe të mundësojnë drejtimin me shkallë të lartë automatizimi;

4.2.4. Shërbimet e C-SIT për infrastrukturën, që mbështesin drejtimin e automatizuar.

4.3. Specifikimet për sistemin për administrimin e kredencialeve të sigurisë të C-SIT:

4.3.1. politika e certifikatave për administrimin e certifikatave digjitale për shërbimet e C-SIT;

4.3.2. përcaktimi i rolit të autoritetit përgjegjës për politikën e certifikatave të C-SIT, administratorit të listës së besueshme të C-SIT dhe pikës së kontaktit të C-SIT;

4.3.3. politika e sigurisë për administrimin e sigurisë së informacionit në C-SIT.

SHTOJCA II
PARIMET PËR SPECIFIKIMET DHE VËNIEN NË ZBATIM TË SIT-it
(në zbatim të nenet 6, 7 dhe 9)

Miratimi i specifikimeve, nxjerrja e mandateve për standardet dhe përzgjedhja dhe vënia në zbatim e aplikimeve dhe shërbimeve të SIT-it bazohen në një vlerësim të nevojave që përfshin të gjitha grupet përkatëse të interesit dhe respekton parimet e mëposhtme. Këto masa:

a)	janë efektive	–	japin një kontribut të prekshëm në zgjidhjen e sfidave kryesore që prekin transportin rrugor në Shqipëri (p.sh. reduktimi i kongestionit/bllokimit, adresimi i situatave të emergjencës dhe fenomeneve të motit, ulja e shkarkimeve, përmirësimi i eficiencës së energjisë, arritja e niveleve më të larta të sigurisë dhe mbrojtjes, edhe për përdoruesit e cënueshëm të rrugëve);
b)	janë ekonomike	–	optimizojnë raportin midis kostove dhe rezultateve me qëllim arritjen e objektivave;
c)	janë proporcionale	–	sigurojnë, sipas rastit, nivele të ndryshme e të arritshme për sa i përket cilësisë dhe vënies në zbatim të shërbimeve, duke marrë në konsideratë specifikat lokale, rajonale, kombëtare dhe evropiane;
ç)	mbështesin vijimësinë e shërbimeve	–	sigurojnë shërbime të pandërprera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht në rrjetin transevropian dhe, kur është e mundur, në kufijtë e saj të jashtëm, në rast të vënies në zbatim të shërbimeve të SIT-it. Vazhdimësia e shërbimeve duhet të sigurohet në një nivel të përshtatur me karakteristikat e rrjeteve të transportit, që lidhin me shtetet e tjera dhe, sipas rastit, rajonet me rajonet dhe qytetet me zonat rurale;
d)	sigurojnë ndërveprueshmëri	–	sigurojnë që aplikimet, shërbimet dhe proceset bazë të biznesit të sistemeve të kenë aftësinë për të shkëmbyer të dhëna dhe për të ndarë informacione dhe njohuri në një format të standardizuar për të mundësuar ofrimin efektiv të shërbimeve të SIT-it;
dh)	mbështesin përputhshmërinë me versione më të vjetra	–	sigurojnë, kur kjo është e justifikuar, aftësinë e sistemeve të SIT-it për të punuar me sisteme ekzistuese që ndajnë një qëllim të përbashkët, pa penguar zhvillimin e teknologjive të reja dhe duke mbështetur, sipas rastit, bashkëveprimin me teknologjitë e reja ose kalimin drejt këtyre teknologjive;
